



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 750/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NNT Eing Com”-Podujevë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull te prokurimit: “Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616/18/7760-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Komuna e Prishtinës” më datën 23.01.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NNT Eing Com”-Podujevë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616/18/7760-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- “Komuna e Prishtinës”

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616/18/7760-5-2-1, AK- “Komuna e Prishtinës” dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“NNT Eing Com”-Podujevë aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:22.10.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:14.11.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit të eliminuar: 06.12.2018

Data e njoftimit për dhënie të kontratës: 06.12.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetin të prokurimit, operatori ekonomik:“NNT Eing Com”-Podujevë me dt: 11.12.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- “Komuna e Prishtinës” me datën 13.12.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:“NNT Eing Com”-Podujevë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues:“NNT Eing Com”-Podujevë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 21.12.2018 me nr. 750/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616/18/7760-5-2-1,të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Komuna e Prishtinës” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 41 i RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.12.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:28.12.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues "NNT Eing Com"-Podujevë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 69 të LPP-së si dhe nenit 41 të RrUOPP, me arsyetimin se kanë rekomanduar për kontratë Eko Group sh.p.k. & OE Rexha Sh.p.k. e cila nuk i plotëson kërkesat dhe dëshmitë e parashtruara në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit respektivisht duke arsyetuar paraqitur faktet dhe dëshmitë me shkelje të bëra nga ana e komisionit të vlerësimit: në dosje të tenderit pika 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional në pozicionin 3 kërkohej: "3. Pajisjet e nevojshme: 1 ekskavator 3 kamionë 1 cilindër 1 traktor për frezim me të gjitha pajisjet adekuate",

Traktor për frezim me të gjitha pajisjet adekuate për të cilin është kërkuar që të dëshmohej me deklarata doganore, librezat e qarkullimit, marrëveshjet për blerjen e pajisjeve ose shfrytëzimin e tyre mbi pronësinë (apo marrjes me qira) të pajisjeve teknike. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një faturë të blerjes duke mos dëshmuar se i ka të gjitha pajisjet e kërkuara në dosje të tenderit. Për më tepër nuk ka asnjë dëshmi mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e traktorit, ashtu siç kërkohej në LIGJIN NR.05/L-132 PER AUTOMJETE dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 01/2018, PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE të lëshuar nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe ministrisë së punëve të brendshme. Në nenin 57 të Ligjit Nr. 05/L-132 targa të regjistrimit përkatësisht Obligimi i Identifikimit thuhet: Mjetet në trafikun rrugor duhet të kanë dy targa të regjistrimit, përveç motoçikletës, mopedit, katërçikletave të lehta, katërçikletave, triçikletave me motor, mjeteve bashkëngjiteshe, traktorit dhe rimorkios të cilat lejohen të kenë një targë regjistrimi. Edhe në ligj edhe në udhëzim administrativ shprehimisht thuhet se traktori duhet të regjistrohet dhe të ketë targa.

Këtë pohim tonin e ka vërtetuar edhe eksperti i OSHP-se z.Sahit Beqiri në ekspertizën me nr. 654/18, 655/18 të datës 26.11.2018 për aktivitetin e prokurimit ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria, në të cilën OE ofertues kemi ofruar pajisje traktor të regjistruar ashtu siç parashihet me Ligj, Nr. 05/L-132 dhe UA (MPB) NR. 01/2018. Komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se duke mos i trajtuar OE në mënyrë të barabartë dhe njëherit ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka ofruar mjete që nuk janë konform dispozitave ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-132 dhe UA (MPB) NR. 01/2018. Kjo është e njëjtë si për kamion të ofrohet dëshmi vetëm DUD-i Doganor, e jo librezat e qarkullimit për faktin se regjistrimi edhe i kamionit edhe i traktorit edhe i mjeteve tjera parashihen në të njëjtin ligj dhe në të njëjtin udhëzim administrativ.

2. Ne dosje te tenderit pika 9.1 & 9.2. Kapaciteti teknik dhe profesional ne pozicionin 2 kërkohet: “2. Staf i nevojshëm: 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv- tri vite përvojë pune 1 inxhinier i diplomuar i arkitekturës - tri vite përvojë pune 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi gjeodezi/bechelor - tri vite përvojë pune 1 teknik i bujqësisë/ekologjisë.Për stafin teknik i bujqësisë. ekologjisë OE i rekomanduar për kontrate ka propozuar z.Jeton Halit Sylaj, me te cilin ka marrëveshje me date 14.11.2018. Ne fillim te CV se tij shkruan emri i tjetër personi Berat Hasanaj. Bashkëpunimi me Jeton Haliti Sylaj është bërë me date 14.11.2018, ndërsa ne CV janë prezantuar pune qe janë kryer ne vitin 2014. Psh.

1.Ndërtimi i rrugëve me kabëza te betonit - Faza e trete 2016

2.Ndërtimi i rrugës Barileve - Besi viti 2015

3.Ndërtimi i trotuarit me ndriçim solar ne Dardhishte viti 2014

Pra te gjitha projektet e paraqitura ne CV janë te përfunduara para se OE Eko group shpk. me pas marrëveshje me te Jeton Sylaj, për me tepër Jeton Sylaj ka qene edhe i pa diplomuar ne atë kohe, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK në njoftimin për kontratë ka parashtruar kërkesën: “Pajisjet e nevojshme: 1 ekskavator 3 kamionë 1 cilindër 1 traktor për frezim me te gjitha pajisjet adekuate” si dhe dëshminë: “3. Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve ,Deklaratat unike doganore Librezat e qarkullimit.” Ndërsa OE e rekomanduar për kontratë se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar ka dorëzuar një fature te blerjes ndërsa komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit përmes letrësstandarde ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë rreth dëshmimeve për traktor dhe OE i rekomanduar ka sqaruar respektivisht pas kërkesës së komisionit të vlerësimit ka dorëzuar në AK:

- Një faturë nr. 156/07 te datës 13.03.2007, ne te cilën është specifikuar blerja e Traktorit TAFE 42 DI nga Kompania “Haxhijaha” Rahovec, ne vlere 7,300.00 € (Në të cilën është specifikuar se për çfarë traktori behet fjale tipi, marka, nr.motorit, sasisë etj.),
- Fletëdergesen e lëshuar nga NPT “Haxhijaha” Rahovec dt. 13.03.2007 për kompaninë “Rexha shpk” ku specifikohet TAFE 42 , si dhe
- Deklaratën unike doganore te datës 02.03.07 ne te cilën specifikohen te dhënat e traktorit TAFE 42 DI (te dhëna identike me ato që gjenden ne faturën e nr. 156/07 te datës 13.03.2007.

Mirëpo eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar librezën e qarkullimit për Traktor sepse AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit e ka kërkuar që të dorëzohetsi dëshmi për mjetet Deklaratat unike doganore Librezat e qarkullimit.

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankuese lidhur me CV e z.Jeton Halit Sylaj te cilin OE e rekomanduar e ka paraqitur në dosjen e tenderit si staf për ta plotësuar kërkesën për teknik të bujqësisë/ekologjisë eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim i OE ankuese **nuk është i bazuar** sepse OE i rekomanduar se bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për punëtorin në fjalë CV, kopjen e diplomës dhe marrëveshjen për angazhim në realizimin e këtij aktiviteti, si dhe për kundër që në fillim të CV-is së këtij punëtori (z.Jeton Halit Sylaj) shkruan emri i tjetër personi “Berat Hasanaj” në brendësin e saj CV-ia përmban emrin dhe të dhënat për z.Jeton Halit Sylaj andaj dëshmitë lidhur me stafin e nevojshëm respektivisht për 1 teknik të bujqësisë/ekologjisëte bashkangjitura nga OE i rekomanduar për kontratë e plotësojnë kërkesën/dëshminë e parashtruar nga AK në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit- si vijon:

Kërkesa:Stafi i nevojshëm: 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv- tri vite përvojë pune 1 inxhinier i diplomuar i arkitekturës - tri vite përvojë pune 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi gjeodezi/bechelol - tri vite përvojë pune 1 teknik i bujqësisë / ekologjie. Dëshmia e kërkuar dokumentare:2.CV-a,Diploma; Kontrata e punës me punëdhënësin valide ose marrëveshje për angazhim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyeje që u ceken tek përgjigjja në pretendimin nr.1), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtrësës me shkrim të datës: 31.12.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 31.12.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.01.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së z. Podvorica deklaroj: Siç u cek edhe me herët ne jemi pajtuar me mendimin e ekspertit qe lënda te kthehet ne rivlerësim për te njëjtat pretendime ankimore paneli shqyrtues ka marrur vendim nr 219/18 te dt 20.06.2018 ku kërkesa e AK-se ka qene qe pajisja

traktor te ofrohet me libreze te qarkullimit valide ndërsa ne rastin tone OE i rekomanduar nuk ka ofruar libreze por vetëm fatura te blerjes se mjetit, ne kërkojmë qe paneli shqyrtues ta pranoj ankesën tone si te bazuar dhe ketë levend ta kthej ne rivlerësim.

Përfaqësuesi i AK- znj. Sekiraqa deklaroj: AK nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit qe lënda te kthehet ne rivlerësim qe mendojmë qe komisioni vlerësuar ka bere vlerësimin e ofertave me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, pretendimi i par ankimor i OE qe përveç dudit doganor qe e ka sjellë OE i rekomanduar te cilën edhe librezën e qarkullimit mendoj qe nuk qëndron AK duke u bazuar edhe ne vendimet e OSHP ne vendime te njëjta ka pasur për qellim te mos bej kufizime te kërkesave lidhur vetëm me një dëshmi por te ju lejoj hapësire OE te dorëzon dokumente relevante me atë kërkesë , ne ketë rast OE ka sjellë dudin doganor i cili ka qen një nder 3 kërkesat për pajisje. Ne vendimin 512/18 te OSHP se qe kërkesat e AK duhet te plotësohen.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti Shqyrtues z. Krasniqi deklaroj: Ashtu siç e kam cek ne raport, ne njërin pretendim qe e ka pasur për staf për OE fitues, sipas mendimit tim OE fitues e ka plotësuar kërkesën ne fjale sepse ka dorëzuar te gjithë dokumentacionin e nevojshëm si qeshte kërkuar nga AK dhe nuk qëndron pretendimi se për teknikun ne fjale është kërkuar edhe përvoja e punës, ndërsa lidhur me pretendimin tjetër qe ka te bej me deklaratat unike për traktorin jam pajtuar me pretendimin e OE ankues për arsye se OE fitues për traktor ka bashkangjitur vetëm deklaratën unike doganore ndërsa nuk ka bashkangjitur librezën e qarkullimit ne rastin konkret mendoj se nuk qëndron fakti siç e tha përfaqësuesi AK se kërkesa ka qen e specifikuar e OE te ofrojnë deklarate Unike doganore ose Libreze te qarkullimit. dhe mbetem prapa mendimit te dhen ne raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje tenenit 7, 59 dhe 69të LPP-së si dhe nenit 41 të RrUOPP, me arsyetimin se kanë rekomanduar për kontrate Eko Group sh.p.k. & OE Rexha Sh.p.k. e cila nuk i plotëson kërkesat dhe dëshmitë e parashtruara në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit respektivisht duke arsyetuar paraqitur faktet dhe dëshmitë me shkelje e bëra nga ana e komisionit te vlerësimit: ne dosje te tenderit pika 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional ne pozicionin 3 kërkohet:”3. Pajisjet e nevojshme: 1 ekskavator 3 kamionë 1 cilindër 1 traktor për frezim me te gjitha pajisjet adekuate për te cilin është kërkuar qe te dëshmohet me deklarata doganore librezat e qarkullimit, marrëveshjet për blerjen e pajisjeve ose shfrytëzimin e tyre mbi pronësinë (apo marrjes me

qira) te pajisjeve teknike. Paneli shqyrtues konform shkresave te lendes deklarimit te palëve ne procedure konstaton se **qëndron** ky pretendim ankimor pasi qe OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar një fature te blerjes duke mos dëshmuar se i ka te gjitha pajisjet e kërkuara ne dosje te tenderit. Për me tepër nuk ka asnjë dëshmi mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e traktorit, ashtu siç kërkohet në dosje te tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankuese lidhur me CV e z.Jeton Halit Sylaj te cilin OE e rekomanduar e ka paraqitur në dosjen e tenderit si staf për ta plotësuar kërkesën për teknik të bujqësisë/ekologjisë Paneli shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit, konstaton se ky pretendim i OE ankuese **nuk qëndron** sepse OE i rekomanduar se bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për punëtorin në fjalë CV, kopjen e diplomës dhe marrëveshjen për angazhim në realizimin e këtij aktiviteti, si dhe për kundër që në fillim te CV-is së këtij punëtori (z.Jeton Halit Sylaj) shkruan emri i tjetër personi “Berat Hasanaj” në brendësin e saj CV-ia përmban emrin dhe të dhënat për z.Jeton Halit Sylaj andaj dëshmitë lidhur me stafin e nevojshëm respektivisht për 1 teknik të bujqësisë/ekologjisëte bashkangjitura nga OE i rekomanduar për kontratë e plotësojnë kërkesën/dëshminë e parashtruar nga AK në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit- si vijon Kërkesa: Staf i nevojshëm: 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv- tri vite përvoje pune 1 inxhinier i diplomuar i arkitekturës - tri vite përvoje pune 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi gjeodezi / beachelor - tri vite përvoje pune 1 teknik i bujqësisë / ekologjie. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2.CV-a,Diploma; Kontrata e punës me punëdhënësin valide ose marrëveshje për angazhim.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 dhe 60 dhe 72 të LPP-së. Paneli shqyrtues duke u bazuar ne ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit obligon AK-në,që gjatë rivlerësim të ofertave të bënë vlerësim real të ofertave sipas kërkesave te vendosura nga vet AK ne njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit dhe konform nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese nga OE i rekomanduar për kontrate konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit se a i plotëson te gjitha kërkesat e vendosura ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet te ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese duhet vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu autoriteti kontraktues duhet vepruar në pajtim me nenin 7, 59 dhe 60 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –“Komuna e Prishtinës”
- 1x1 OE- “NNT Eing Com”-Podujevë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.